

PËR PJEKJET E RILINDASVE SHQIPTARË PËR MËSIMIN DHE SHKRIMIN  
E GJUHËS SHQIPE GJATË VITEVE 1830-1878

TEMA PËR TITULLIN  
MASTER I SHKENCËS NË PROGRAMIN HISTORI E KOHËS SË RE

nga

ARBEN PRENKU



UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI FILOZOFIK

DEPARTAMENTI I HISTORISË

PRISHTINË

Maj, 2024

## RYZEME

### PËRPPJEKJET E RILINDASVE SHQIPTARË PËR MËSIMIN DHE SHKRIMIN E GJUHËS SHQIPE GJATË VITEVE 1830-1878

Mentori: Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti

Kandidati: Arben Prenku

Ky punim diplome trajton një temë mjaftë interesante dhe shumë të rëndësishme siç është “Përpjekjet e Rilindasve Shqiptarë për Mësimin dhe Shkrimin e Gjuhës Shqipe gjatë viteve 1830-1878”. Qëllimi kryesor i punimit është që të trajtohen përpjekjet e rilindasve shqiptarë për mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe, në veçanti gjatë viteve 1830-1878. Duke përcaktuar këtë periudhë si një ndër më të rëndësishmet sa i përket kontributit të rilindasve shqiptarë për mësimin dhe shkrimin në gjuhën shqipe. Po ashtu në punim do të pasqyrohet në mënyrë më të detajuar ndikimi që patën reformat e para centralizuese të Perandorisë Osmane në raport me mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe, si dhe do të pasqyrohen po ashtu edhe përpjekjet e para të rilindasve shqiptarë përballë reformave të para centralizuese si dhe gjendja e arsimit në Shqipëri gjatë viteve 45-60 të shek.XIX.

Në këtë punim gjithashtu do të pasqyrohet për gjendjen e arsimit dhe shkrimit në Shqipëri gjatë viteve 60-70, si dhe kontributin e disa figurave të rëndësishme të rilindësve shqiptarë për mësimin dhe shkrimin e gjuhës shqipe gjatë kësaj periudhe. Po ashtu do të pasqyrohen përpjekjet e mëdha të rilindësve shqiptarë nga fillimi i viteve '70 shek.XIX deri në vitin 1878 për sigurimin e të drejtës për të mësuar dhe shkruar në gjuhën shqipe, është bërë përpjekje maksimale që ky punim shkencor të pasqyrohet drejtë, me objektivitet, pa ndikime dhe duke implementuar metodat adekuate shkencore si: Përshkrimin, Analizën, Krahasimin.

Ky punim përbëhet nga: katër kapituj dhe njëzet nënkaptuj, fotografi, burime dhe literatura, gazeta, revista.

Kapitulli i Parë trajton: Fillimet e ideologjisë e të kulturës kombëtare. Kapitulli i Dytë trajtonë: Gjendjen e arsimit në Shqipëri gjatë viteve 45-60 të shek.XIX, në këtë kapitull trajtohet

gjendja nëpër të cilën kalonte arsimi në Shqipëri gjatë kësaj kohe. Kapitulli i Tretë trajton: Mësimin dhe shkrimin kombëtar gjatë viteve 60-70 të shek.XIX, në këtë kapitull elaborohet kryesisht për mësimin dhe shkrimin kombëtar gjatë këtyre viteve. Kapitulli Katërt trajton: Përpjekjet e mëdha të rilindasve shqiptarë nga fillimi i viteve 70-të shek.XIX deri në vitin 1878 për sigurimin e të drejtës për të mësuar dhe shkruar në gjuhën shqipe. Pas përfundimit, janë Fotografitë, Burimet dhe Literatura, Gazeta, Revistat.